



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
KËSHILLI DREJTUES

Nr. Prot. _____

Tiranë ___/___/2023

VENDIM QARKULLUES

Nr. 6, datë 20.03.2023

PËR
MIRATIMIN E “RAPORTIT VJETOR TË
AGJENCISË SË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE PËR VITIN 2022”

Në bazë dhe në zbatim të nenit 7, të nenit 52, pika 1, shkronja “l” dhe të nenit 53, pika 5, shkronja “ë” të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar, të nenit 7, pika 6 dhe të nenit 8, pika 2, shkronja “d” të Statutit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, të nenit 10, pika 6 dhe të nenit 18, pika 2 të Rregullores “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, të miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014, si dhe me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues,

V E N D O S I:

1. Miratimin e “Raportit Vjetor të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2022”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi qarkullues.
2. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për paraqitjen e Raportit Vjetor pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Këshillit të Ministrave dhe Autoritetit Mbikëqyrës, sipas afateve të përcaktuara në ligjin nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar.





3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi qarkullues dhe të Raportit Vjetor në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Shqipe Malaj

Sekretare

Donald Duraj

Kryetar

